

## Koalicioni per arsimimin e femijeve ne Shqiperi

Friday, 23 April 2010

FRONTPAGE\_NO\_TRANSLATION\_AVAILABLE Në kuadër të Fushatës Globale &ldquo;Edukim për të gjithë&rdquo; u lajt sot për herë të parë një prej ndeshjeve më të veçanta në historinë e futbollit shqiptar mes fëmijëve në nevojë dhe të rinjve të skuadrës së Dinamos. Ky aktivitet unik sportiv u zhvillua nga Koalicioni për Arsimimin e Fëmijëve në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Federatën Shqiptare të Futbollit dhe Sport-klub Dinamon. Ndeshja u mbyll me rezultatin 4-3 për skuadrën e fëmijëve në nevojë. Fushata Globale &ldquo;Arsim për të Gjithë&rdquo; është një fushatë ndërgjegjësuese mbi rëndësinë e arsimit bazë për çdo fëmijë në të gjithë botën e cila nga viti në vit ka bashkuar zërin e fëmijëve të shoqërisë civile, politikanëve dhe zyrtarëve qeveritarë.

Drejtori i CRCA, z. Altin Hazizaj, në emër të Koalicionit për Arsimimin e Fëmijëve në Shqipëri i kërkoi Qeverisë shqiptare nëpërmjet që të shohë me prioritet çështjet e arsimit të fëmijëve, duke financuar për cilësinë e shërbimit arsimor në Shqipëri; të zbatojë politika arsimore gjithëpërfshirëse dhe jo përjashtuese për asnjë target grup; dhe të zbatojë politika mbështetëse për fëmijët që punojnë, fëmijët e komunitetit Rom, fëmijët me aftësi të kufizuar.

Zv/ministrja e Arsimit dhe Shkencës znj. Nora Malaj, e cila ishte gjithashtu e pranishme në këtë event bëri të ditur se këtë vit, 60 përqind e fëmijëve nga grupet e marginalizuara, si nga komuniteti rom, egjiptian të cilët e kishin braktisur shkollën, këtë vit janë regjistruar sërish. Sipas saj, kjo është një prej treguesve që tregon se në Shqipëri nismat kundër analfabetizmit kanë filluar të japin rezultatet e tyre.

Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit z. Eduard Prodani u shpreh se përmes sportit fëmijët mund të socializohen dhe të mos jenë më nëpër rrugë, atje ku mund të bien pre e veseve. Ai u bashkua gjithashtu në thirrjen e përbashkët për të kontribuar të gjithë për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e edukimit.

Prej vitesh me radhë, në të gjithë Botën, përfshirë edhe Shqipërinë, gjatë muajit Prill, zhvillohet Java Globale &ldquo;Edukim për të Gjithë&rdquo;. Këtë vit kjo javë do të zhvillohet më 19-25 Prill 2010 nën moton &ldquo;1 GOL PËR EDUKIMIN&rdquo;.

Që nga fillimi i Fushatës Globale &ldquo;Arsimim për të Gjithë&rdquo; më shumë se 30 milion fëmijë në të gjithë botën janë regjistruar në shkollë dhe numri i fëmijëve në të gjithë botën që nuk shkojnë në shkollë ka rënë në 80 milion. Kjo ka bërë që numri i personave të rritur analfabet ka rënë në 800 milion.

Në të gjithë botën, këtë vit Fushata Globale &ldquo;Edukim për të Gjithë&rdquo; do të organizohet në 2010. Figura të rëndësishme të Futbollit Botëror si: Del Piero, Zinedine Zidane, Robinho, Robin Van Persie kanë organizuar në kuadër të kësaj fushate ndeshje futbollit me fëmijë apo i kanë kushtuar një gol Fushatës Globale &ldquo;Edukim për të Gjithë&rdquo;.

Koalicioni për Arsimimin e Fëmijëve beson se arsimimi i fëmijëve dhe sigurimi i kushteve për shkolla sa më miqësore duhet të jenë prioritetet kryesore të Qeverisë shqiptare dhe shoqërisë në përgjithësi. Arsimi ka një ndikim të padiskutueshëm në uljen e varfërisë, rritjen e nivelit arsimor dhe kulturor të shoqërisë dhe krijimin e një force aktive për punë, të aftë të integrohet dhe konkurojë në tregun ndërkombëtar.